



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMA E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2019:267639
Datë: 03.06.2025
Numri i dokumentit: 07344579

K.DH.SH.II.nr.1525/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS – Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Dren Rogova, kryetar, Krenar Berisha dhe Faton Bajrami, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT Sh.A, me numër të regjistrimit të biznesit 70325350, me seli në Prishtinë, rr. “Isa Boletini”, nr. 39, përfaqësuar me autorizim nga B.H., kundër të paditurit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës, me seli në Prishtinë, përfaqësuar nga Avokatura Shtetërore, për shkak të anulimit të vendimit nr. 01/37-123/19-A-1 të datës 07.03.2019 dhe vendimin me nr. prot. 323 i datës 12.06.2019, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.188/22 të datës 30.06.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 05.06.2025, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e paditësit Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT Sh.A, me numër të regjistrimit të biznesit 70325350, me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.188/22 të datës 30.06.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me Aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, KA.nr.188/22 të datës 30.06.2023, është refuzuar në tërësi kërkesëpadia e paditësit Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu - KOSTT Sh.A, me të cilin ka kërkuar të anulohet vendimi nr. 01/37-123/19-A-1 të datës 07.03.2019 si dhe vendimin me nr.prot. 323/19 i datës 12.06.2019, të nxjerrë nga i padituri Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale - Inspektorati i Punës.

Kundër këtij aktgjykimi ka ushtruar ankesë paditësi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozimin që të aprohet ankesa e paditësit të prishet aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë dhe çështja t’i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe rivendosje.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të ankimuar në kuptim të nenit 12 të Ligjit nr.08/L-015 për Gjykatën Komerciale, dhe nenit 194 të Ligjit për Procedurën

Kontestimore, në drejtim të thënieve në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës vlerëson se:

- Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se Paditësi KOSTT, ka parashtruar padi me kërkesë për anulimin e vendimit të organit të shkallës së parë të Inspektoratit të Punës (IP) nr. 01/37-123/19-A-1 i datës 07.03.2019 si dhe vendimit të organit të shkallës së dytë nr. 323/2019 i datës 12.06.2019 si të kundërligjshëm, me arsyetimin se këto vendime janë nxjerrë nën vërtetim të gabuar të gjendjes faktike dhe se nuk janë zbatuar dispozitat e procedurës administrative dhe Ligjit të Punës. Paditësi ka pretenduar se vendimi i atakuar përmban shkelje procedurale dhe materiale dhe është i pas afatshëm në kuptim të nenit 98 par. 1 dhe 2 të LPPA-së si dhe nenit 6.2 të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe UA nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik përmes së cilit përcaktohet afatshmëria. Lidhur me këtë i njëjti ka theksuar se ka nënshkruar kontratat e punës me kandidatët e suksesshëm, pasi që nuk ka pranuar asnjë ankesë nga kandidatët e eliminuar dhe pjesëmarrës në konkurs. Paditësi gjithashtu lidhur me shpalljen e konkursit publik për praktikant ka theksuar se i njëjti është realizuar konform dispozitave ligjore të përcaktuara sipas Ligjit të Punës, UA nr.07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik dhe aktit të brendshëm të KOSTT - Politika e rekrutimit dhe elektimit, ashtu që ndërhyrja e Inspektoratit të Punës gjatë procesit të konkursit është e kundërligjshme. Ka shtuar se Ligji i Punës askund nuk e përmend se ndalohet punësimi i praktikantëve për pozita të caktuara pune dhe nuk potencon përsëritjen të konkursit pas kalimit të periudhës të praktikantit, por gjithnjë i referohet kontratës kolektive dhe akteve të brendshme, ashtu që punëdhënësi e ka në kompetencë këtë çështje derisa ligji nuk e potencon dhe nuk e ndalon një gjë të tillë. Gjithashtu ka theksuar se qëllimi i punëdhënësit KOSTT ka qenë që të aftësoj praktikantët profesionalisht për kryerje të pavarur të detyrave të caktuara për pozitat përkatëse të shpallura si në konkursin publik të datës 25.07.2018. Në seancën e shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka qëndruar pranë padisë dhe kërkesëpadisë ashtu që i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj si të bazuar padinë e paditësit dhe ti anuloj vendimet kontestuese me nr. 01/37-123/19-A-1 i datës 07.03.2019 dhe vendimit nr. 323/2019 i datës 12.06.2019 të nxjerrë nga e paditura.

Gjykata e shkallës së parë, ka mbajtur seancën e shqyrtimit kryesor dhe pasi vlerësoi vendimin e kundërshtuar dhe pas administrimit të provave, erdhi në përfundim se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar dhe të njëjtën e refuzoi si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Deri te ky vlerësim gjykata e shkallës së parë erdhi pasi që nga provat e administruara ka rezultuar se i padituri ka vepruar drejtë kur ka refuzuar ankesën e paditësit me të cilën ka kërkuar që të anulohet aktvendimi përmes së cilit, Inspektorati i Punës si organ i shkallës së parë ia ka shqiptuar paditësit masën ndëshkimore për arsye se i njëjti me rastin e pranimi të kandidatëve për pozitat e punës si praktikant të cilët kanë pasur përvojë pune profesionale, ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës, i cili përcakton kohëzgjatjen e praktikës, kriteret dhe kushtet për tu përzgjedhur. Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit kontestues i'u referuar nenit 94 të Ligji Nr. 03/L-212 të Punës. Kështu gjykata e shkallës së parë vlerësoi se me dispozitat e Ligjit të Punës nenin 16 par. 4 parashihet shprehimisht kohëzgjatja e punës praktike ashtu që ka gjetur se kandidatët e përzgjedhur kanë përvojë pune profesionale apo janë në përfundim të praktikës tek i njëjti punëdhënës, në këtë rast paditësi, nga e cila rezulton se të njëjtën kanë përvojë të punës dhe nuk e përmbushin kriterin që të zgjidhen prapë në të njëjtën pozitë tek i njëjti punëdhënës sipas konkursit për praktikant, ngase e kanë të përfunduar praktikën sipas afatit kohor të përcaktuar me dispozitat e lartcekura. Ndërsa lidhur me shqiptimin e masës

ndëshkimore nga e paditura Organi i Shkallës së Parë – Inspektorati i Punës, gjykata vlerëson se kjo masë ndëshkimore është e drejtë dhe e ligjshme duke u bazuar në dispozitat e nenit 7 par. 2 pika 2.4 të UA nr. 07/2012 i cili përcakton se: *“Prej 100 deri në 7,000€, për çdo shkelje të dispozitës së: ... 2.4. Neni 16, paragrafi 16.4, kohëzgjatja e punës praktike të praktikantit”*, ashtu që gjoba e shqiptuar nga IP është drejtë dhe e ligjshme duke marrë parasysh shkeljet e konstatuara nga paditësi me rastin e realizimit të konkursit në kundërshtim me dispozitat e Ligjit të Punës.

Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë i Gjykatës Komerciale në Prishtinë, këtë qëndrim juridik të gjykatës së shkallës së parë, e vlerëson si të rregullt dhe të bazuar në ligj, për arsye se aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me zbatim të gabuar të dispozitave ligjore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore (LPK). Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative (LKA), në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës, aktgjykimin e ka mbështetur në dispozitat e Ligjit Nr. 2002/9 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, të plotësuar dhe ndryshuar me Ligjit Nr. 03/L-017, Neni 2, ku përcaktohen funksionet e Inspektoratit të punës. Po ashtu gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar kur është mbështetur në Ligjin nr. 03/L-212 të Punës neni 94, i cili përcakton se Mbikëqyrja e zbatimit të dispozitave të këtij ligji, të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës, sigurinë në punë dhe mbrojtjen në punë e bën Inspektorati i Punës në bazë të Ligjit për Inspektoratin e Punës dhe Ligjit nr. 2003/9 për sigurinë në punë, mbrojtje të shëndetit të punësuarve dhe ambientit të punës".

Sa i përket pretendimeve ankimore kjo gjykatë rithekson se vendimi kontestues në konfliktin administrativ ka të bëjë me gjobën për shkak të shkeljeve të dispozitave të Ligjit të Punës, shkelje këto që inspektorati i ka evidentuar me rastin e kontrollit tek subjekti në procedurë. Pretendimet ankimore se e paditura ka tejkaluar autorizimet sipas Kolegjit janë pretendime të cilat gjykata nuk mund t'i merr për bazë pasi që në çështjen konkrete objekt shqyrtimi është gjoba e shqiptuar me vendimin kontestues. Ndërkaq paditësi nuk ka ndjekur procedurën lidhur me pretendimet për tejkalim të autorizimeve sa i takon vendimeve paraprake të cilat i kanë paraprirë shqiptimit të gjobës. Rrjedhimisht, shkeljet e gjetura nga inspektorati në procedurën e brendshme administrative janë evidente, për çka vendimi kontestues administrativ nuk është i përfshirë me shkelje të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Nga të lartcekurat, kolegji vie në përfundim se aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë me shkelje të dispozitave Konfliktit Administrativ dhe dispozitave të ligjit për Procedurën Kontestimore neni 182, pasi gjykata e shkallës së parë, gjatë procedurës drejtë i ka zbatuar dispozitat e LKA. Kolegji vlerësoi se këto pretendime nuk janë të bazuara dhe të argumentuara në provat e lëndës dhe në dispozitat ligjore në fuqi, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadsisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre.

Gjithashtu Kolegji, konsideron se gjykata e shkallës së parë, ka zbatuar drejt ligjin kur ka nxjerr konstatimin se paditësi ka rënë ndesh me dispozitat ligjore nga neni 53 par.1 dhe Neni 49 të

Ligjit të Punës. Në këtë drejtim, Kolegji gjen se aktgjykimi i atakuar mbështetet në dispozitat konkrete të Ligjit të Punës, ku janë gjetur parregullsi nga lëmi i marrëdhënies së punës me rastin e inspektimit nga organi administrativ, e ky i fundit ka pasur autorizime ligjore për gjobën e shqiptuar dhe të cilat hyjnë në fushëveprimin ligjor të saj.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovon edhe kjo Gjykatë.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, Kolegji i Dhomës së Shkallës së Dytë, konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit, thëniet e ankesës ky Kolegj nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se pretendimet ankimore ishin pa ndikim në vërtetimin e gjendjes tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhoma e Shkallës së Dytë
K.DH.SH.II.nr.1525/23 datë 05.06.2025

Kryetar i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova

